



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:056488

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05541462

KPPP.nr.780/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Afri Trade” N.P.T, me NRB: 80162642, me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Alija Ajro, avokat nga Prizreni, kundër debitorit N.P.T. “Florenti”, me NRB: 811305334, me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.20/2022 të datës 03.03.2022, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 03.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.P.T. “Florenti”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.20/2022 i datës 03.03.2022, i Përmbartuesit Privat Enis Hoxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.20/2022 i datës 03.03.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Afri Trade” N.P.T, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.20/2022 të datës 03.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 1-2/81545 të datës 10.12.2020; Faturës Nr. 1-2/81565 të datës 10.10.2020; Faturës Nr. 1-2/81571 të datës 10.12.2020; Faturës

Nr. 1-2/81579 të datës 10.12.2020; Faturës Nr. 1-2/69355 të datës 22.10.2020; Faturës Nr. 1-2/69354 të datës 22.10.2020; Faturës Nr. 1-2/69353 të datës 22.10.2020; Faturës Nr. 1-2/69353 të datës 22.10.2020; Faturës Nr. 1-2/90350 të datës 24.12.2018; Faturës Nr. 1-2/90412 të datës 24.12.2018; Faturës Nr. 1-2/88424 të datës 17.12.2018; Faturës Nr. 1-2/88422 të datës 17.12.2018; Faturës Nr. 1-2/89453 të datës 20.12.2018; Faturës Nr. 1-2/17844 të datës 18.03.2019; Faturës Nr. 1-2/17732 të datës 18.03.2019; Faturës Nr. 1-2/18642 të datës 21.03.2019; Faturës Nr. 1-2/18670 të datës 21.03.2019; Faturës Nr. 1-2/31895 të datës 09.05.2019; Faturës Nr. 1-2/31909 të datës 09.05.2019; Faturës Nr. 1-2/25252 të datës 15.04.2019; Faturës Nr. 1-2/25264 të datës 15.04.2019; Faturës Nr. 1-2/25263 të datës 15.04.2019; Faturës Nr. 1-2/53503 të datës 01.08.2019; Faturës Nr. 1-2/53505 të datës 01.08.2019; Faturës Nr. 1-2/53507 të datës 01.08.2019; Faturës Nr. 1-2/53520 të datës 01.08.2019; Faturës Nr. 1-2/44059 të datës 27.06.2019; Faturës Nr. 1-2/44058 të datës 27.06.2019; Faturës Nr. 1-2/44021 të datës 27.06.2019; Faturës Nr. 1-2/44010 të datës 27.06.2019; me të cilën është detyruar debitori që në emër të obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekurat nga dita e pranimit të urdhrit të paguaj shumën prej 3,731.22 € në emër të borxhit kryesor, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbarimit, në të kundërtën organi përmbarues të bllokuj të gjitha llogaritë bankare të debitorit deri në pagimin e shumës totale të borxhit, ndërsa në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme në llogari bankare, atëherë përmbarimi të zbatohet në tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se në rastin konkret faturat nuk janë të përshtatshme për përmbarim, sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare. Më tutje ka deklaruar se ky urdhër është në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit të palëve, ku kërkohet se çfarëdo kompensimi i mjeteve nuk mund të bëhet pa barazimin e obligimeve të operatorëve ekonomik të debitorit, ashtuqë vetëm pas konfirmimit të obligimeve nga pala debitore, pastaj do të përmbushen të gjitha obligimet financiare. Ka shtuar se nga analizimi i shkresave të lëndës del se kreditori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij i cili ka qenë barazimi i saldove financiare, duke mos përmbushur detyrimin e tij, e qe rrjedhimisht kërkesa për përmbarim është e papranueshme nga fakti se nuk janë plotësuar kriteret paraprake. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të vërtetohen parregullsitë, si dhe të priset urdhri për lejimin e përmbarimit.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se në rastin konkret faturat i plotësojnë të gjitha kushtet dhe se afati për pagesë është paraparë në kontratën e bashkëpunimit afarist dhe se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Në lidhje me përmbushjen e kërkesave ka deklaruar se ka dorëzuar dhe furnizuar me mall debitorin, e që vërtetohet se faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt, palët kanë barazuar detyrimet e tyre, si dhe konstatohet se kreditori i ka përmbushur obligimet e tij nga kontrata. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 1-2/81545 të datës 10.12.2020; Faturën Nr. 1-2/81565 të datës

10.10.2020; Faturën Nr. 1-2/81571 të datës 10.12.2020; Faturën Nr. 1-2/81579 të datës 10.12.2020; Faturën Nr. 1-2/69355 të datës 22.10.2020; Faturën Nr. 1-2/69354 të datës 22.10.2020; Faturën Nr. 1-2/69353 të datës 22.10.2020; Faturën Nr. 1-2/69353 të datës 22.10.2020; Faturën Nr. 1-2/69352 të datës 22.10.2020; Faturën Nr. 1-2/90350 të datës 24.12.2018; Faturën Nr. 1-2/90412 të datës 24.12.2018; Faturën Nr. 1-2/88424 të datës 17.12.2018; Faturën Nr. 1-2/88422 të datës 17.12.2018; Faturën Nr. 1-2/89453 të datës 20.12.2018; Faturën Nr. 1-2/17844 të datës 18.03.2019; Faturën Nr. 1-2/17732 të datës 18.03.2019; Faturën Nr. 1-2/18642 të datës 21.03.2019; Faturën Nr. 1-2/18670 të datës 21.03.2019; Faturën Nr. 1-2/31895 të datës 09.05.2019; Faturën Nr. 1-2/31909 të datës 09.05.2019; Faturën Nr. 1-2/25252 të datës 15.04.2019; Faturën Nr. 1-2/25264 të datës 15.04.2019; Faturën Nr. 1-2/25263 të datës 15.04.2019; Faturën Nr. 1-2/53503 të datës 01.08.2019; Faturën Nr. 1-2/53505 të datës 01.08.2019; Faturën Nr. 1-2/53507 të datës 01.08.2019; Faturën Nr. 1-2/53520 të datës 01.08.2019; Faturën Nr. 1-2/44059 të datës 27.06.2019; Faturën Nr. 1-2/44058 të datës 27.06.2019; Faturën Nr. 1-2/44021 të datës 27.06.2019; Faturën Nr. 1-2/44010 të datës 27.06.2019; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin si dhe vulën e pranimit nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për kohën e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.780/23, datë 03.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.